



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. protokollli 377

dt. 11.11.2019

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62, paragrafi 62.3 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 57, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01 - 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe në dispozitat e nenit 6, të Rregullores nr. 01-110-41917, dt. 29.03.2013 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

**KONKURS**

**PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

I. Komuna e Prishtinës ndanë **120 bursa** për studentët që studiojnë në universitetet publike të Kosovës, për vitin akademik 2019/2020, në këto fusha të studimit:

Fakulteti i Arteve .....	katër(4) bursa
Fakulteti i Shkencave Sportive.....	katër (4) bursa
Fakulteti Juridik.....	katër (4) bursa
Fakulteti Ekonomik .....	katër (4) bursa
Fakulteti Filologjik.....	gjashtë (6) bursa
Fakulteti i Edukimit.....	dhjetë(10) bursa
Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës.....	trembëdhjetë(13) bursa
Fakulteti Filozofik.....	tetë (8) bursa
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.....	trembëdhjetë (13) bursa
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës .....	dymbëdhjetë (12) bursa
Fakulteti i Mjekësisë.....	katërbëdhjetë (14) bursa
Fakulteti i shkencave matematiko-natyrore.....	katërbëdhjetë (14) bursa
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike .....	katërbëdhjetë (14) bursa

II. Vetëm studentët/et e rregullt, se paku 10 vjet banorë të komunës së Prishtinës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të universitetit publik të Republikës së Kosovës,



duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave komunale.

### III. Kriteret e përgjithshme:

1. Të kenë regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
2. Të mos jetë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
3. Të mos jetë përsëritës i vitit akademik;
4. Të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes.
5. Studentët që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme.

### IV. Kriteret e veçanta:

1. nota mesatare mbi 9 (nëntë) vlerësohet me 30 pikë,
2. nota mesatare mbi 8 (tetë) vlerësohet me 20 pikë,
3. nota mesatare mbi 7 (shtatë) vlerësohet me 15 pikë,
4. studentët në asistencë sociale vlerësohen me 20 pikë,
5. studentët që studiojnë në lëndët deficitare vlerësohen me 15 pikë,
6. ai/ajo, që studion së bashku me një anëtar tjetër nga e njëjta familje vlerësohet me 10 pikë,
7. ai/ajo, që nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 10 pikë,
8. studentët me nevoja të veçanta vlerësohen me 10 pikë.

**Vëmendje:** Kriteret e veçanta sipas pikës gjashtë (6), vlerësohen vetëm për një student të asaj familje dhe vetëm nëse dëshmon me dokumentacion zyrtar së të gjithë studentët e asaj familje i plotësojnë kriteret e përgjithshme.

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në pikën IV, do të kenë përparësi studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, të gjinisë femërore dhe studentët që udhëtojnë nga fshati me larg se 15 km.



### V. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-së së studentit;
3. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2019/2020 (origjinale);
4. Certifikata e notave (origjinale);
5. Certifikata/Ekstrakti i lindjes;
6. Certifikata për përfundimin e shkollës fillore (kopje). **Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti do të konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Prishtinës me tepër se 10 vite;**
7. Kopja e letërnjoftimit;
8. Vërtetimi nga administrata tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune.



*Për anëtarin e ngushtet të familjes së dëshmorëve edhe:*

9. Vendimi/Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve

*Për anëtarin e ngushtë të familjes në asistencë sociale edhe:*

10. Vendimi/Vërtetimi që dëshmon se aktualisht është shfrytëzues i ndihmës sociale (origjinale);

*Për studentët pa prindër edhe:*

11. Certifikata e vdekjes;

*Për studentët e regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2019-2020 edhe:*

12. Kopjet e vërtetuara të dëftesave dhe të diplomës për përfundimin e shkollës së mesme.

*Për anëtarët e ngushtet të së njëjtës familje edhe:*

13. Certifikatat/Ekstraktet e lindjes për të gjithë student anëtar të ngushtë të asaj familje

*Për studentët me nevoja të veçanta:*

14. Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

**Vërejtje:** Dokumentet e pakompletuara sipas kritereve të lartcekura, dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.** Aplikacioni i kërkesës merret dhe i plotësuar dorëzohet në sportelet e katit përdhës të Komunës të Prishtinës (ndërtesa e vjetër), çdo ditë pune prej orës 10:00 deri 15:00.

*Drejtorja e Arsimit*

Shpresa Shala, drejtor